



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:188207  
Datë: 21.11.2024  
Numri i dokumentit: 06486326

C.nr.6644/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjykatësit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit: A.N nga P, Rr. "A.V ", Blloku ..., Hyrja ..., kati ..., nr ..., kundër të paditurit: "K.I", sh.p.k, me seli në P, Rr. "E.M" nr., me numër unik identifikues ... dhe numër biznesi ..., i përfaqësuar nga A.M - Drejtor Menaxhues, me objekt të kontestit kompensimin e mjeteve, vlera e tërësishme e kontestit 1,880.00 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik të datës 12.11.2024, në prezencën e paditësit personalisht, e në mungesë të palës së paditur, me datë 21.11.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.N nga P, përmes së cilës ka kërkuar që të: "*DETYROHET i padituri "K.I", me seli në P, që në emër të pagesës së mjeteve për monitorimin e disertacioneve për periudhën kohore nga dt.14.04.2015 deri me dt.10.03.2019, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,880.00 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kërkesës, dt.28.03.2019, e deri në pagesën definitive.*"

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësi A.N nga P, pranë kësaj Gjykate me dt.06.08.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurit "K.I" sh.p.k, me seli në P, me objekt të kontestit kompensimin e mjeteve në emër të monitorimit të disertacioneve. Si në referatin e padisë, ashtu edhe përgjatë seancave të mbajtura, ndër tjera ka pretenduar që ka qenë i angazhuar pranë të paditurit si bashkëpunëtor i jashtëm në detyrën e ligjëruesit, duke shtuar se sipas kontratës së punës paditësit, përveç pagës për mbajtjen e ligjëratave i takon edhe pagesa për monitorimin e disertacioneve të cilat i ka mbajtur, por që nuk i është kompensuar. Tutje ka pretenduar se me të paditurin ka themeluar marrëdhënie pune sekondare, e jo marrëdhënie të rregullt pune dhe kjo e fundit nuk i ka përmbushur detyrimet e veta kontraktuale sa i përket pagesës për monitorimin e disertacioneve. Më tej ka theksuar se paditësi i është drejtuar edhe Inspektoratit të Punës, me ç'rast organi i shkallës së dytë ka aprovuar ankesën e të njejtit, duke konstatuar se paditësi është kompensuar për mbajtjen e ligjëratave, por jo edhe për monitorimin e disertacioneve, andaj sipas gjetjeve të Inspektoratit të Punës duhet të zbatohet Vendimi Nr.02-2015 i datës 14.04.2015 mbi Skemën e Kompensimit për Monitorimin e Disertacioneve. Mbi bazën e pretendimit se i padituri nuk e ka respektuar vendimin e lartcekur, me qëllim të realizimit të të drejtës

së pretenduar, ka inicuar padi pranë Gjykatës kompetente. Pretendimet e palës së paditur i ka kundërshtuar në tërësi, mbi bazën e argumentit se nga shkresat e lëndës rezulton që si punë primare e ka mbajtur atë në Policinë e Kosovës, ndërsa e ka pasur aprovimin e këtij institucioni lidhur me angazhimin tek i padituri. Lidhur me këto pretendime, i është referuar listës së pagave, të lëshuar nga ATK, duke theksuar se nga kjo provë vërtetohet fakti se i njëjti nuk ka pranuar pagë muaj për muaj tek i padituri, siç ka pranuar në Policinë e Kosovës, si dhe deklarimit pranë Agjencisë Kosovare për Akreditim. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, në petitum të kërkesëpadsisë të specifikuar në seancën përgaditore të dt.22.10.2024, ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet i padituri që në emër të pagesës së mjeteve për monitorimin e disertacioneve për periudhën kohore nga dt.14.04.2015 deri me dt.10.03.2019, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,880.00 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kërkesës, dt.28.03.2019, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

Pala e paditur, si përmes përgjigjes në padi të deponuar në Gjykatë me dt.09.11.2021, ashtu edhe në seancën përgaditore të mbajtur me dt.22.10.2024 dhe parashtrësës së deponuar jashtë seancës gjyqësore me dt.05.11.2024, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, si për nga baza, ashtu edhe lartësia. Fillimisht pretendohet se për të njëjtën çështje ekzistojnë dy vendime gjyqësore, vendimi i parë mban shenjën PPP.nr.1872/2019, me të cilin vendim është aprovuar prapësimi i këtu të paditurit ndaj Urdhërit Përmbarimor, ndërsa vendimi tjetër mban shenjën KA.nr.239/22, me të cilin është aprovuar kërkesëpadija e këtu të paditurit dhe është anuluar vendimi nr.355/2019, i dt.25.06.2019, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës si i kundërligjshëm. Tutje ka pretenduar se paditësi ka punuar si ligjërues i rregullt pranë të paditurës, e jo si ligjërues i “angazhuar”, duke shtuar se deklarimi i pagës së paditësit në ATK, si pagë sekondare nuk nënkupton dhe nuk e përcakton faktin që i njëjti ka qenë ligjërues/punëmarrës i rregullt apo i angazhuar, pasi që deklarimi si pagë sekondare bëhet për ata persona të cilët kanë të deklaruar pagë primare në një institucion tjetër. Tutje pala e paditur pretendon që në bazë të Vendimit Nr.2-2015, të datës 14.04.2015 mbi Skemën e Kompensimit për Mentorimin e Disertacioneve, pika I e këtij Vendimi thotë: *“Përfitues të kësaj skeme janë vetëm ligjëruesit e K.I me kontrata me angazhim ...”*. Më tej ka shtuar se në çdo kontratë të punës të nënshkruar mes palëve ndërgjyqëse, që nga viti 2012, në nenin 3 të kontratës është paraparë statusi i paditësit, ku është e qartë që i njëjti ka qenë i angazhuar si staf i rregullt, e jo si staf me angazhim dhe në momentin e nënshkrimit të kontratës, punëmarrësit i kanë të qarta të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kontrata e punës, ndërsa në rastin konkret i padituri nuk ka pasur për detyrim që t'ia paguajë paditësit shpenzimet për mentorimin të temave të diplomës. Më tej, e paditura ka parashtruar se në lidhje me listat e emrave të studentëve për të cilat paditësi ka pretenduar se i ka mentoruar temat e punimeve të diplomës, e njëjta është e hartuar nga vetë paditësi sipas deklarimit të tij dhe shihet qartë se shumat për kompensim nuk korrespondojnë fare me vendimin Nr.02-2015 të datës 14.04.2015, si dhe kjo listë nuk përmban asnjë nënshkrim apo vulë të të paditurës, me të cilën do të vërtetonte saktësinë e shumave të specifikuara. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar Gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.12.11.2024, ka administruar provat materiale si në vijim:

*Kontrata e punës Nr.86/17, e datës 02.12.2017; Ankesa e datës 28.03.2019, drejtuar Inspektoratit të Punës; Kontrata e punës për kohë të pa caktuar, me numër reference 7756, e datë 01.12.2010; Lista e pagave, e lëshuar nga ATK, nr.protokolli 235/19, e datë 24.04.2019; Ankesa e datës 25.04.2019, drejtuar Kryeinspektorit të Punës; Vendimi nr.protokolli 355/2019, i datës 25.06.2019, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës; Raporti Zyrtar 01 Nr.33-39/2016, i përpiluar me datë 04.04.2019 nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës; Vendimi Nr.02-2015, i datës 14.04.2015 mbi skemën e kompensimit për mentorimin e disertacioneve; Vendimi për punësim, nr.reference 07/1-01A/8341, i datës 21.12.2016 i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës; Vendimi për punësim, nr.reference 07/1-01A/7452, i datës 05.12.2017, i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës; Kërkesa për shkëputjen e kontratës, e datës 10.03.2019, e dorëzuar në formë elektronike; Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.1872/19, i datës 07.05.2020; Padia e datës 20.08.2019; Lista e monitorimit të distertacioneve; Pasqyra e llogarisë së paditësit në Trustin Pensional; Lista e pagave nr.protokolli 116/24, e datës 16.10.2024; Kërkesa për qasje në dokumente publike; Vendimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ref.2151/24, i datës 21.10.2024; Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, KA.nr.239/22, i datës 08.11.2023.*

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes të veçantë dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç si dhe të gjitha së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga provat shkresore të administruara, por edhe në bazë të pohimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas Gjykatës fillimisht rezulton të jetë *i pa kontestuar* fakti se paditësi, gjatë periudhës kontestuese (14.04.2015 - 10.03.2019), ka qenë në marrëdhënie pune me palën e paditur.

Çështje thelbësore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ngelet statusi i paditësit në kuadër të marrëdhënies së punës pranë të paditurit, gjegjësisht fakti nëse i njejt i ishte në marrëdhënie të rregullt të punës apo *i angazhuar* (me punë jo të rregullt), si dhe çështja tjetër që përbën fakt kontestues përkon në atë nëse i padituri ka pasur për detyrim që t'ia paguajë paditësit kompensimin e mjeteve në emër të mentorimit të temave të diplomës, fakte këto për të cilat palët ndërgjyqëse kanë ngritur pikëpamje diametralisht të ndryshme nga njëra - tjetra.

Në bazë të Vendimit mbi Skemën e Kompensimit për Mentorimin e Disertacioneve, Nr.02-2015, të datës 14.04.2015, i nxjerrë nga pala e paditur, Gjykata gjeti se me këtë vendim ka përcaktuar kategorinë e ligjëruesve të cilët përfitojnë nga një skemë e tillë, ku në pikën I të këtij Vendimi parashihet se: "*Përfitues të kësaj skeme janë të gjithë ligjëruesit e K.I me kontrata me angazhim, të cilët janë përzgjedhur për të mentoruar temat e kandidatëve që kanë mbaruar provimet e ciklit respektiv të studimeve.*"

Në bazë të Kontratës së Punës për kohë të pa caktuar, me Nr.Reference 7756, të datës 01.12.2010, Gjykata gjeti se paditësi kishte themeluar marrëdhënie pune me kohë të pa caktuar dhe me orar të plotë pranë Policisë së Kosovës, dhe atë i sistemuar në vendin e punës "*Drejtor i Drejtorisë për Inteligjencë dhe Analizë.*"

Në bazë të Vendimit Nr.reference 07/1-01A/8341, të datës 21.12.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, Gjykata gjeti se paditësit i është lejuar nga punëdhënësi - Policia e Kosovës, të angazhohet jashtë detyrës tek i padituri.

Në bazë të Ankesës së datës 28.03.2019, drejtuar Inspektoratit të Punës, Raportit Zyrtar 01 Nr.33-39/2016, të përpiluar me datë 04.04.2019 nga Inspektorati i Punës, si dhe Vendimit Nr.protokolli 355/2019, të datës 25.06.2019, të nxjerrë nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, Gjykata gjeti se pas dorëzimit të ankesës së paditësit tek ky institucion, kjo e fundit kishte vendosur që fillimisht të refuzojë si të pa bazuar ankesën, ndërsa në shkallën e dytë në procedurë administrative është aprovuar ankesa sa i përket pjesës lidhur me çështjen e kompensimit të mentorimit të disertacioneve. Ky institucion, në arsyetim të vendimit të lartëcekur, kishte gjetur se paditësi ishte i angazhuar në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm në detyrën e ligjëruesit dhe ndaj të njëjtit duhet të zbatohet Vendimi Nr.02-2015, i datës 14.04.2015 mbi Skemën e Kompensimit për Mentorimin e Disertacioneve. Gjykata vlerëson se vendimet e lartëcekura të Inspektoratit të Punës paraqesin një dimension dhe natyrë tjetër të vendimmarrjes së një organi të ekzekutiv/administrativ, e që Gjykata nuk është e lidhur në vendosjen sipas procedurës gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës, mirëpo nga ana tjetër vlerëson se paraqet të gjetura nga një institucion përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit të punës, i cili kishte hetuar rastin dhe kishte bërë vlerësimin diskrecional përmes vendimeve të lartcekura.

Në bazë të Vendimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Ref.nr.2151/24, të datës 21.10.2024, si dhe shkresave të bashkangjitura këtij Vendimi, Gjykata gjeti se paditësi pranë kësaj Agjencie, me datë 26.11.2014 kishte deklaruar se është në marrëdhënie të rregullt pune pranë Policisë së Kosovës, kurse është i angazhuar pranë "K.I", me seli në P - këtu i padituri. Po ashtu, sipas Deklarimit për vitin akademik 2017/2018 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, të datës 17.09.2017, tek pika 2 të titulluar "Të dhënat lidhur me angazhimin" tek rubrika "Institucioni (Full-Time)" paditësi e ka vendosur Policinë e Kosovës, kurse tek rubrika "Institucioni (Part-Time)" paditësi e ka vendosur "K.I" - këtu të paditurin.

Në bazë të listës së pagave të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës me nr.protokolli 116/24, e datës 16.10.2024, Gjykata gjeti se për të ardhurat e paditësit nga e paditura për periudhën kontestuese në rubrikën "PRIMARE" në këtë kolonë është dhënë përgjigja "JO".

Në bazë të dokumentit të titulluar "Borgji nga kompenzimi per mentorim të disertacioneve 1880 Euro", Gjykata vëren se në këtë listë janë të përfshira disa emra të profesorëve në cilësi të anëtarëve të komisionit dhe mentorëve për disa studentë të niveleve të ndryshme të studimit të cilët do t'i mbrojnë disertacionet e tyre respektive, si dhe disa data dhe shuma monetare.

Gjykata bëri shtjellimin e të gjitha provave të administruara, kurse kryesisht në arsyetimin e aktgjykimit, iu referua provave që kishin relevancë të drejtpërdrejtë dhe ndikim vendimtar në shqyrtimin dhe vendosjen përkitazi me këtë çështje juridike kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Vlerësimi i Gjykatës -

Gjykata rikujton se çështje kryesore kontestuese midis palëve ndërgjyqëse mbetet fakti i statusit të paditësit në kuadër të marrëdhënies së punës, gjegjësisht nëse i njëjti e ka cilësinë e të punësuarit të

*rregullt/primar apo i angazhuar/sekondar, si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensim të mjeteve në emër të mentorimit të disertacioneve për cikle të ndryshme të studimit është e themeltë.*

Gjykata ka për detyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike, dhe rrjedhimisht atë gjendje - raport ta mbështesë / vendosë nën normën juridike relevante materiale dhe konkrete, ashtu siç është përcaktuar nga ligjvënësi. Në aspektin e të drejtës materiale të aplikueshme, Gjykata i referohet dispozitave të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.11.2010, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozita nga neni 1, e cila i referohet qëllimit të këtij ligji përcakton që: *“Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj”*. Në anën tjetër, dispozita nga neni 2, e cila i referohet fushës së zbatimit, përcakton: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”*. Dispozita e nenit 10 par.1 përcakton se *“Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.”* Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se marrëdhënia e punës është një marrëdhënie që normohet juridikisht përmes kontratës së punës. Kontrata e punës përfaqëson një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhënien e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese. Përmes saj, punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pa caktuar kohore, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të punëdhënësit, në kundërvlerë të pagës mujore.

Nga Kontrata e Punës Nr.86/17, e dt.02.12.2017, e lidhur në mes të paditësit në cilësi të punëmarrësit dhe të paditurit në cilësi të punëdhënësit, Gjykata gjeti se në pjesën hyrëse të saj saktësohet detyra e paditësit si punëmarrës, e që është: *“Ligjërues”*. Për më tepër, Gjykata rikujton se palët kontraktuese në momentin e nënshkrimit të kontratës i kanë pranuar të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me këtë kontratë.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, me nënshkrimin e Kontratës së Punës të lartcekur, nuk është saktësuar qartë statusi që paditësi kishte tek pala e paditur, por në këtë kontratë vetëm ishte e definuar pozita e punës së paditësit: *“Ligjërues”* si dhe detyrat e punës sipas nenit 4 të Kontratës së Punës. Po ashtu, në këtë kontratë nuk është e rregulluar çështja e orarit të punës, por vetëm është përcaktuar se punëmarrësi do t'i kryejë detyrat dhe punës *“sipas orarit të planifikuar”*.

Gjykata vlerëson se Ligji i Punës në tërësinë e tij, nuk e njeh mundësinë e lidhjes së dy apo më tepër marrëdhënieve të rregullta të punës me orar të plotë. Konkretisht, sipas nenit 20 par.2 përcaktohet që: *“Orari i plotë i punës zgjatë dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe”*. Duke qenë se sipas Kontratës të Punës me kohë të pa caktuar e datës 02.11.2012, të lidhur në mes të Policisë së Kosovës në cilësi të punëdhënësit dhe A.N - këtu paditësit në cilësi të punëmarrësit, në nenin 6 të saj parashihet që: *“I punësuarit themelon marrëdhënie pune me orar të plotë. Orari i plotë i punës zgjatë dyzet (40) orë në javë, duke përfshirë edhe punën në tri ndërrime. Modelet e punës me ndërrime i përcakton punëdhënësi”*. Po ashtu, Gjykata i referohet nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2016 për plotësimin/ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 01/2016 për zbatimin e Ligjit Nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale i datës 13.03.2016, ku përcaktohet se: *“Punëdhënësi, përmes deklarimit të listës së pagesës mujore në formatin elektronik të përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, cakton se i punësuarit ka përzgjedhur atë si punëdhënësi kryesor apo jo”*. Në referim të këtyre dispozitave, Gjykatës i rezulton se detyrimi për deklarimin e paditësit përkitazi me statusin e punësimit të tij, është i punëdhënësit - këtu të paditurit

dhe nga deklaratimet tatimore sipas listave të pagave të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, Nr.Protokolli 116/24 e datës 16.10.2024, paditësi është evidentuar si punëmarrës *jo primar*. Po ashtu, në këtë linjë të argumentimit Gjykata bazohet edhe në deklaratimin e paditësit pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim të datës 26.11.2014, ku paditësi e ka evidentuar si marrëdhënie të rregullt të punës punën pranë Policisë së Kosovës. Po ashtu, sipas Vendimit Nr.reference 07/1-01A/8341, të datës 21.12.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, vërehet se paditësi nga punëdhënësi i tij primar - Policia e Kosovës ka kërkuar leje sipas procedurave të brendshme që të angazhohet jashtë detyrës tek pala e paditur, dhe i një kërkesë e tillë është miratuar.

Për më tepër, edhe në dy deklaratimet e bëra nga ana e paditësit pranë Agjencisë Kosovare për Akreditim, përmbajtja e të cilave është elaboruar më sipër, i njëjti ka deklaruar para këtij institucioni se si punëdhënës primar / me orar të plotë e ka Policinë e Kosovës, kurse punësimi i tij tek i padituri është me orar jo të plotë / pra i natyrës sekondare.

Mbi bazën e një gjendje të tillë faktike të vërtetuar, Gjykata vlerëson se Kontrata e Punës e lidhur midis paditësit dhe të paditurit, rrjedhimisht marrëdhënia juridike e punës së krijuar midis palëve ndërgjyqëse, kishte statusin e punësimit *jo të rregullt (sekondar)*, “*argumentum a contrario*”, paditësi nuk kishte statusin e të punësuarit të rregullt.

Gjykata përkitazi me vlerësimin e themelësisë juridike të kërkesës së paditësit për kompensimin e të ardhurave, i referohet nenit 55 par.1 të Ligjit të Punës ku përcaktohet se: “*I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*”.

Në çështjen konkrete kontestimore, Gjykata i referohet Vendimit Nr.02-2015 të datës 14.04.2015 mbi Skemat e Kompensimit për mentorimin e disertacioneve, ku në pikën I të këtij Vendimi parashihet se: “*Përfitues të kësaj skeme janë të gjithë ligjëruesit e K.I me kontrata me angazhim, të cilët janë përzgjedhur për të mentoruar temat e kandidatëve që kanë mbaruar provimet e ciklit respektiv të studimeve. Përzgjedhja bëhet me aprovim të Zyrës së Cilësisë dhe Zyrës së Shërbimit të Studentëve, pas aplikimit të studentit për zyrtarizim të temës*”. Në pikën II të këtij Vendimi parashihet se: “*Skema e kompensimit është e ndarë në tri nivele kompensimesh: 1. Mentorimi i temave të nivelit Master. Për temat e nivelit Master, të cilat vlerësohen me 30 ECTS, dhe kërkojnë angazhim të madh të mentorëve, kompensimi do të jetë 100 € bruto për disertacion. 2. Mentorimi i temave të nivelit Bachelor. a. Për temat e nivelit Bachelor, të cilat vlerësohen me 30 ECTS, të cilat kërkojnë përcjellje të dedikuar të mentorëve, kompensimi do të jetë 75 € bruto për disertacion. b. Për temat e nivelit Bachelor, të cilat vlerësohen me më pak se 30 ECTS, dhe përgatiten gjatë semestrit të rregullt së bashku me lëndë tjera, kompensimi do të jetë 50 € bruto për disertacion*”.

Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura, pasi që Gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ishte i punësuar në marrëdhënie pune të rregullt (me orar të plotë), Gjykata vlerëson se paditësit, *në parim*, i takon e drejta e kompensimit në emër të mentorimit e temave të disertacioneve, sepse një kompensim i tillë buron nga aktet e brendshme të punëdhënësit - këtu të paditurit, të miratuara nga i njëjti subjekt.

Thënë të gjitha këto, fakt kontestues përkitazi me kërkesën e paditësit mbetet edhe çështja e lartësisë së kërkesëpadisë, të cilën pala e paditur e ka kontestuar në të gjitha fazat e procedurës. Në lidhje me këtë fakt, paditësi në cilësinë e provës materiale ka bashkangjitur dokumentin e emëruar: “*Borgji*

nga kompenzimi per mentorim te disertacioneve 1880 Euro”. Dokumenti i lartëcekur përmban disa të dhëna ku përfshihen: emra, data dhe shuma të caktuara monetare, mirëpo në mënyrën se si është prezantuar, Gjykata çmon se një prove të tillë i mungon fuqia provuese përkitazi me faktin e lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit, pasi që e njëjta nuk përmban ndonjë shenjë evidentuese (vulë të protokollit, nënshkrim), që do të jepte informacione më të sakta përkitazi me autorësinë e këtij dokumenti, si dhe faktin e pranimit, verifikimit apo aprovimit të të dhënave që përmban ky dokument. Mbi këtë bazë, dokumenti në fjalë nuk e provon faktin se paditësi ka kryer shërbimet e pretenduara në raport me palën e paditur, respektivisht se të njëjtit i takon vlera e pretenduar për kompensim sipas shumës së specifikuar.

Gjykata në këtë drejtim i referohet nenit 8 par.1 të LPK-së e cila parasheh që: *“Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë te rezultatit të gjithë procedimit”*. Përmes kësaj dispozite, ligjvënësi ka parashikuar parimin e çmuarjes së lirë të provave përgjatë zhvillimit të procedurës kontestimore (civile). Parimi i çmuarjes së lirë të provave nënkupton se nuk parashikohen rregulla procedurale për zgjedhjen, shfrytëzimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese. Gjykata, nuk është e lidhur, e as e kufizuar me rregulla të posaçme formale për të provuarit. Pretendimin për fuqinë provuese të një prove që flet për ekzistimin ose jo të një fakti relevant juridik, Gjykata e vlerëson vetëm pasi të jetë bindur në fuqinë provuese dhe saktësinë e saj.

Për me tepër, Gjykata i referohet nenit 7 par.1 të LPK-së ku parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Në rastin konkret, Gjykata në asnjë fazë të procedurës nuk pranoi propozim nga palët për nxjerrjen e një prove tjetër nga mjetet provuese të njohura nga legjislacioni në fuqi. Po ashtu, Gjykata i referohet nenit 7 par. 2 të LPK-së ku parashihet se: *“Gjykata është e autorizuar t’i vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe t’i marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”*. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se objekti kontestit - kërkesa e paditësit nuk hyn në kategorinë e kërkesave nga neni 3.3 i LPK-së, që i referohet kërkesave për të cilat palët ndërgjyqëse nuk mund të disponojnë lirisht, andaj duke respektuar në mënyrë strikte rolin e saj pasiv në procedurë, nuk ndërmoi veprime procedurale *ex officio*, përkitazi me nxjerrjen e ndonjë prove që do të kishte relevancë dhe rëndësi për shqyrtimin dhe vendosjen përkitazi me këtë çështje juridike kontestimore. Një vlerësim të tillë, Gjykata e bazon edhe në domosdoshmërinë e garantimit të paanësisë së saj kundrejt palëve ndërgjyqëse përgjatë zhvillimit të procesit kontestimor dhe vendosjes meritore. Parimi i paanësisë nënkupton që Gjykata duhet të marrë vendimet e saj pa favorizim apo supozim të favorizimit apo mos favorizimit ndaj ndonjë palë ndërgjyqëse. Po ashtu, parimi i paanësisë përbën *element qenësor* të së drejtës në gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, të njohur edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila në nenin 31 par.2 parasheh që: *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”*. Po ashtu, neni 102 par.4 përcakton se: *“Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm”*. Në linjë të njëjtë të argumentimit, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çështjet që i përkasin nxjerrjes së provave paraqesin çështje që kryesisht duhet të rregullohen (normohen) me

*ligjin kombëtar dhe gjykatat kombëtare* (shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], kërkesa Nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28). E njëjta vlen edhe për fuqinë provuese të provave dhe barrën e të provuarit (shih rastin *Tiemann kundër Francës dhe Gjermanisë* Nr.47457/99 dhe 47458/99, Aktgjykim i datës 27 prill 2000). Në dritën e vlerësimeve të lartcekura, çdo veprim ndryshe nga ana e Gjykatës do të cenonte mjaftueshëm parimin e paanësisë, andaj, në një situatë të tillë faktike dhe juridike, Gjykata gjeti se paditësi ka dështuar të provojë çështjen e lartësisë së kërkesëpadisë, rrjedhimisht Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë si të pa bazuar.

- *Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës* -

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450, lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyqfituese, nuk ka paraqitur kërkesë të specifikuar lidhur me shpenzimet e procedurës.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitës nga neni 142, lidhur me nenin 160 të LPK-së, u vendos decidivisht si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL -  
C.nr.6644/21, datë 21.11.2024

Gjyqtari,  
Blerand Rrmoku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.